



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

*Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa*

01Nr 06-12458 /26

Klinë, dt: 05.05 /26

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.03.2026, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Enver Berisha, i cili përshëndeti nënkryetarin e komunës z. Fadil Gashi, drejtorët e drejtorive, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të gjithë të pranishmit .

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i propozimit për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 dhe viteve paraprake në vitin 2026;
4. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për ndarjen e mjeteve buxhetore për mbajtjen e festivalit “I Këndojmë Lirisë”;
5. Shqyrtimi i propozimit për ndërrimin e titullarit të pronave të BVI-së;
6. Shqyrtimi i propozimit për rindërtimin e sheshit të qytetit të Klinës;
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa 2025–2026;
8. Të ndryshme.

Komiteti për Politikë dhe Financa, përveç shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, si pika shtesë në rend dite shqyrtoi:

1. Kërkesë nga OVL-UÇK me nr. Prot. 01-221-7475/2026 të datës 13.03.2026;
2. Propozimi për zgjedhjen e delegatëve për AKK-së.

Enver Berisha, kryesues: Kjo është mbledhja e parë për këtë vit e Komitetit për Politikë dhe Financa. Unë ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj një fillimvit të mbarë.

Besoj se ju, si anëtarë të komitetit, e keni marrë materialin me kohë dhe vazhdojmë me rendin e ditës. Kush është për këtë rend dite, me mungesën e një anëtari të VV-së, por besoj se vjen? Te pika “të ndryshme” kemi disa çështje për informim formal: një kërkesë e shoqatave të dala nga lufta; njoftimi për një vendim formal lidhur me një vizitë jashtë vendit (Gjermani); si dhe një njoftim tjetër për përfaqësimin në një aktivitet, ku pritet të marrin pjesë 6 persona (kryetari dhe dy anëtarë, kjo mbetet të jetë nga radhët e AAK-së dhe tjetra nga radhët e PDK-së).

Po, urdhëro, Esat?

Esat Raci: Faleminderit. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kryesues, unë nuk kam marrë fare material; sapo u njoftova se edhe anëtarja tjetër s’ka marrë fare material. Mund t’ju njoftoj se përmes telefonit e kam thirrur punëtorin e kuvendit, Ahmetin, dhe me gojë më kanë thënë se me 18-tin është; arsyen nuk e di. Mundet me email zyrtar. Materiali i fundit më ka ardhur më 24 shkurt, materiali shtesë i kuvendit. Sido që të jetë, kësaj radhe le t’i tejkalojmë në këtë mënyrë, por herave tjera kisha kërkuar që një punëtor vazhdimisht të na kontaktojë dhe t’i marrë arsyet apo përgjegjësitë e veta. Jo vetëm si anëtarë të komisionit të komiteteve, mirëpo pse jo edhe të gjithë anëtarët e kuvendit të pyeten. Nuk është punë e zorshme me i marrë numrat e telefonit të secilit anëtar të kuvendit dhe të secilit anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komiteteve tjera. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Esat. Unë kërkoj falje për këto që ju kanë ndodhur, por këtu duket që materiali ju ka shkuar. Realisht nuk e di; ndoshta është mirë me kontaktuar edhe këtë zyrtarin e IT-së, me i kontrolluar adresat e emailit, se edhe unë vetë kam pasur pengesa.

Nikson Daka, drejtor i KGJP: Më falni, ne kemi pasur kërkesë prej ASHI-së, që është duke e bërë përmirësimin e sistemit, por besoj në kuadër të kësaj ka ndodhur.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. Po, urdhëro nënkryetar.

Fadil Gashi, nënkryetar: Faleminderit. Unë po ju përshëndes dhe po ju uroj për mandatin e ri në KPF. Ma mori drejtori Niksoni këtë pjesë; na ka ardhur të gjithëve, edhe juve që keni adresë zyrtare. Ju njoftojmë se, pas ndryshimeve të bëra në infrastrukturën e rrjetit pa tela (wireless), janë përditësuar manualet përkatëse të përdorimit. Është e gjatë tash shkresa dhe kanë pasur atje përmirësime. Unë dje kam shkuar në zyrë të Ahmeti dhe e kam marrë materialin. Kjo nuk do të thotë me u arsyetu, për atë që e the ti, nuk është e zorshme me komuniku, absolutisht.

Me 6 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika1. Arsyetimi i mungesave

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, nënkryetar. Po kthehemi edhe njëherë te arsyetimi i mungesave. Përfaqësuesja e Vetëvendosjes ka lajmëruar që do të vijë, por ende s’ka ardhur.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Enver Berisha, kryesues: Ky procesverbal është i mandatit të kaluar, mirëpo është obligative që ne si komitet ta aprovojmë, për shkak se duhet të regjistrohet si material i përmbyllur. Nuk e di a ka dikush diçka me shtu rreth këtij procesverbali; nëse jo, atëherë kisha kërkuar aprovimin e këtij procesverbali. Faleminderit.

Me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i propozimit për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2025 dhe viteve paraprake në vitin 2026.

Enver Berisha, kryesues: Besoj për këtë pikë referon drejtori i Financave, z. Faruk Smajli.

Faruk Smajli, drejtor i FEZH: Faleminderit shumë, kryesues. Këto mjete janë nga tejkalimi i të hyrave vetanake. Konfirmojmë se nuk ka ndonjë ndryshim në strukturën e shpenzimeve, por këto bartje janë në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve, si dhe bartjen në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Te mallrat dhe shërbimet janë **310,300.70 €**, për shpenzime të kontraktuara për vitin 2025, d.m.th. shpenzime që i kemi obligime ndaj operatorëve. Te shpenzimet komunale janë **120,000.00 €** për mbulimin e obligimeve të bartura; këto janë shpenzime për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit, ngrohje qendrore, pompa termike, këto që janë nëpër shkolla. Te subvencionet dhe transferet janë **26,244.65 €**; këto shpenzime janë për ndihmë financiare për shpenzime të varrimit, përkrahjen e zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë. Ndërsa te shpenzimet kapitale janë **368,596.76 €**; këto janë kontrata të lidhura gjatë vitit 2025 që kanë mbetur obligime për t'u kryer. Këto janë, d.m.th., nuk ka diçka tjetër. Nëse keni ndonjë pyetje tjetër rreth kësaj, jam këtu.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Ju e keni edhe një kërkesë shtesë, drejtor; na ka ardhur dje. Ndoshta është mirë edhe këtë, nëse ka nevojë, me jua sqaruar, nëse ka dallime mes këtyre dy shkresave që ju i keni ndryshuar.

Faruk Smajli, drejtor i FEZH: Po, është një ndryshim në vlerë prej **10,000.00** euro, që tërhiqen prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe shtohen te Drejtoria për Arsim; edhe këto janë për mbulimin e shpenzimeve të Drejtorisë së Arsimit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Urdhëroni, fjala është e juaja, z. Valmir Baca.

Valmir Baca: Faleminderit, kryesues. Ne e kemi pranuar materialin për bartjen e këtyre mjeteve; po ashtu e kemi pranuar edhe arsyeshmërinë për secilën kategori. Pasi nuk ka asnjë ndryshim, ashtu siç e tha edhe drejtori, nuk ka asnjë ndryshim në strukturën e shpenzimeve dhe

jemi pro bartjes së këtyre mjeteve.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. A ka dikush tjetër? Meqenëse këto kalojnë përmes asamblesë, nëse dikush ka diçka shtesë, mundet edhe në asamblenë komunale. A ka dikush diçka tjetër të shtojë? Nëse jo, kush është për?

Esat Raci: Kryesues, veç një sqarim: pasi është nënkryetari këtu, a kemi nevojë të marrim vendim apo vetëm ta ngrehim dorën? Sepse roli i Komitetit për Politikë dhe Financa dihet, nuk është vendimmarrës. Unë prej të kaluarës po flas; unë e di që veç rekomandime jep Komiteti për Politikë dhe Financa.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit shumë Esat. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2025, vitet paraprake dhe tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2025 në vitin 2026, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për ndarjen e mjeteve buxhetore për mbajtjen e festivalit “I Këndojmë Lirisë”.

Enver Berisha, kryesues: D.m.th., kjo është një traditë për të cilën besoj që nuk e di a ka nevojë me hap debat. Vlera është diku rreth 30,000.00 euro; ata kanë kërkuar për t’i ndarë për festivalin “I këndojmë lirisë”. Nëse dikush mendon që ka diçka të thotë, urdhëroni, fjala është e juaja. Nëse jo, atëherë kush është për ta rekomanduar këtë shumë për seancën e asamblesë?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozimi të kaloi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i propozimit për ndërrimin e titullarit të pronave të BVI-së.

Enver Berisha, kryesues: Kjo është një kërkesë që na ka ardhur nga Drejtorja e Kadastrit. Drejtorin e kemi këtu dhe besoj që ai ka me na dhënë disa sqarime shtesë rreth kësaj kërkesë. Urdhëro, drejtor.

Nikson Daka, drejtor i KGJP: Faleminderit, kryesues. Në bazë të konsultimeve me zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, po ashtu edhe me asociacionet e komunave dhe Ministrinë e Infrastrukturës, kam mbledhur informacion mbi zbërthimin apo kalimin e pronave të BVI-së, e njohur si Bashkësia për Vetëqeverisjen e Interesit, e cila ka pasur status në kuadër të komunës, por që tash nuk ka. Na është thënë që komuna e gëzon të drejtën e menaxhimit të

këtyre pronave dhe, përkatësisht, përmes kuvendit duhet të bëhet edhe kalimi i titullarit të tyre në pronë shoqërore komunale. Subjekt i kalimit të këtyre pronave është interesi publik, sepse ka lokale dhe grupe të interesit që shfrytëzojnë prona të BVI-së, kështu që nuk vjelet taksa ose detyrimet financiare komunale. Andaj, në kuadër të kësaj, kërkoj që ta votoni dhe ta kalojmë pronësinë në emër të komunës. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. A ka dikush nga anëtarët e komitetit? Nëse jo, unë veç një çështje e kam: një diçka me drejtorin dhe me të tjerët, para se të shkojë në seancë kjo kërkesë, është mirë edhe njëherë të konsultohet zyra ligjore dhe të harmonizohet në bazë ligjore ky ndërrim i pronës. Ose kjo mund të kalojë edhe përmes drejtorisë pa ardhur në kuvend fare, por sido që të jetë është mirë, që mos të vijmë kërkesat dhe me u kthyer nga Ministria e Pushtetit Lokal për aspektin e bazës ligjore. Kush është për rekomandim të kësaj kërkesë në asamblenë komunale?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Propozimit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozimit të kaloi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6 . Shqyrtimi i propozimit për rindërtimin e sheshit të qytetit të Klinës,

Enver Berisha, kryesues: Unë besoj se për këtë do të referojë drejtori i Urbanizmit, z. Enver Berisha, bashkë me stafin që është këtu.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit, kryesues. Të nderuar anëtarë të KPF-së, ne kemi bërë një prezantim në PowerPoint, me qëllim që paraprakisht të shihet se cila është ideja për rindërtimin e sheshit. E dimë që përditë kalojmë nëpër atë rrugë, e shohim dhe e shkelim, dhe gjithashtu shohim se një numër i madh i qytetarëve po ankohen në formë verbale që ky shesh nuk po i plotëson kriteret e lëvizjes, dëmtohen makinat, ka telashe, ka pluhur, bie edhe baltë dhe shumë gjëra tjera.

Me e marrë përsipër që ky të riparohet përditë ka kosto shumë të madhe të mirëmbajtjes, andaj ne kemi këtë propozim, me kusht që ta marrim vendimin edhe të kuvendit. Modelin që e shihni këtu do ta prezantojmë edhe përmes email-eve. Ideja është që një pjesë e kalldrëmit, prej rreth 8,500 metrave katrorë sa është i tërë sheshi, të hiqen rreth 5,000 metra katrorë, të lihet rrethi që është për dizajn, të lihen anësoret dhe të veprohet vetëm në brezin rrugor prej 7 metrash, me vendosjen e dy shtresave asfalt sipas standardeve.

Këtu e kemi bërë një prezantim të vizionit: përmirësimi i qarkullimit, rritja e sigurisë, ulja e zhurmës, këto janë disa prej qëllimeve. Ideja është që rrethi të jetë i rregulluar me kalldrëm, që është më i qëndrueshëm, dhe të vendoset një anësore me granit. Ka një gjatësi rreth 900 metra në tri krahë, dhe nëse shumëzohet me brezin prej 7 metrash, del një sipërfaqe prej rreth 5,000–6,000 metrash katrorë.

Kostoja është afërsisht 400,000–540,000 euro, varësisht prej ofertave të operatorëve. Ideja është që kjo formë të mos ndryshohet në tërësi, por të përmirësohet pjesa e dëmtuar. Gjithashtu kemi planifikuar që përgjatë shtegut të biçikletave dhe këmbësorëve të bëhet gjelbërim, qoftë në tokë

apo me vazo mbi tokë, kjo do të varet edhe nga mendimet e ekspertëve.

Në fund, kemi paraparë vendosjen e gurëve anësorë (me kuarc ose granit, me ngjyrë të zezë ose ngjyrë betoni), për të dalluar shtresën e asfaltit nga pjesa e gjelbërimit dhe nga pjesa për biçikleta dhe këmbësorë. Kjo pjesë do të riparohet pothuajse komplet. Do të shqyrtojmë edhe çështjen e autoparkingjeve, a do të mbeten apo do të hiqen, në varësi të vendimit. Megjithatë, dizajni aktual i parasheh, duke pasur parasysh nevojat e qytetarëve.

Mendoj që kjo ide do ta rrisë sigurinë, do ta lehtësojë mirëmbajtjen dhe do ta ulë koston.

Gjithsesi, ju mund të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja. Mjetet janë të siguruar për implementimin e këtij projekti, shumica nga performanca dhe një pjesë nga bashkëfinancimi.

Faleminderit; nëse ka pyetje, jam këtu.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Para se t'ia jap fjalën anëtarëve të komitetit, kam dy-tri çështje: e para, jam shumë i vetëdijshëm për situatën, por nuk ka lëvizje në qendër të qytetit që qytetarët të mos ndalen e të pyesin çfarë po ndodh dhe a do të ndryshojë kjo gjendje në shesh. Të gjithë janë të interesuar, sepse realisht është bërë pothuajse e pakalueshme për shkak të pengesave në rrugë.

E dyta, nuk e di nëse kjo është bërë me vlerësim të ekspertëve, por besoj që do të ishte në interes të të gjithëve që gjendja të përmirësohet, sepse aktualisht është pothuajse e pariparueshme. Kemi provuar disa herë me riparime, por nuk kanë dhënë rezultat, për shkak të mënyrës si janë të lidhura elementet dhe lëvizjes së tyre. Fjala është e juaja, kushdo që është i interesuar, urdhëroni.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: A mund të shtojë edhe diçka?

Enver Berisha, kryesues: Po, urdhëroni, drejtor.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: E di që shpesh shtrohet pyetja pse po ndërrohet tani, kur është bërë një investim më herët. Sipas informatave që kam marrë nga operatori që e ka realizuar projektin, ai ka qenë i paraparë kryesisht për këmbësorë, jo për qarkullim të makinave. Në atë rast do të kishte funksionuar, por meqenëse tani përdoret nga veturat, kalldrëmi nuk mund të qëndrojë. Prandaj mendoj që është më e arsyeshme që të bëhet si rrugë e shtruar.

Enver Berisha, kryesues: Mirë, faleminderit. Urdhëroni, z.Valmir Baca.

Valmir Baca: Faleminderit, kryesues. Kam dy pyetje rreth projektit të kaluar: sa ka qenë kostoja e projektit dhe a ka pasur pranim teknik ky shesh? Faleminderit.

Rindërtimi i këtij sheshi është tashmë i domosdoshëm; qytetarët e qendrës e dinë që është esencial për shkak se është totalisht jashtë funksionit. Drejtori dha përgjigje për koston e planifikuar prej 450,000 euro. Personalish, mendoj që shtyllat antiparking janë të panevojshme për shkak të imazhit dhe për shkak se qytetarët janë të vetëdijshëm dhe nuk parkojnë veturat anash. Do të ishte më mirë të përqendrohemi në gjelbërim.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Unë kam marrë informacion për projektin në kohën kur më është dashur të kërkoj nga operatori që ta bëjë një termin në kuadër të sigurimit, pasi ka pasur sigurim 2-vjeçar dhe ka qenë në vitin 2022. Unë e kam parë se përafërsisht kanë qenë 1.5 milionë. Me sa di unë, ka qenë një punë shtesë pastaj dhe, kur janë bërë bashkë me punët shtesë, është bërë 1 milion e 560 mijë në total. Mirëpo këtu po ju tregoj se në pjesën e parë, ne mund ta

vendosim në ankand; kemi vendosur t'i nxjerrim në ankand kubezat, të përfitojmë edhe prej kësaj pjese. Nuk është që ta lehtësojmë barrën buxhetore dhe besoj se operatorët do të ofrojnë për t'i blerë, dhe ajo pjesë të vendoset për rindërtim. Pranimi teknik i projektit ka qenë diku në vitin 2018, me sa kam parë unë. Ka pasur sigurim 2-vjeçar, nuk është në kuadër të sigurimit dhe gjendja e tij është në nivel.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Dikush tjetër? Urdhëro, Esat.

Esat Raci: Faleminderit, kryesues. Çka ka nevojë të ndërhyhet në punimet e sheshit, ku çdo qytetar e di dhe e sheh se çka ka nevojë për ndërhyrje? Kësaj radhe, unë personalisht nuk do të votoj për shkak të materialit dhe e lëmë për diskutime më të gjera. Por ajo që pyeti Vali: a është bërë pranimi teknik nga ky pushtet në vitin 2018? Edhe për koston, drejtori e dha që hyn komplet infrastruktura nëntokësore në atë kosto. Por unë kisha pasur një kërkesë që në këtë seancë të jenë edhe ekspertët e kompanisë që e kanë ndërtuar, jo drejtori, por inxhinierët ekspertë. Enveri ka qenë nënkryetar në atë kohë te ne. Në qoftë se s'gabo, atëherë ka qenë vetëm për kamionë dhe autobusë të mos ketë kalim kënde, jo për vetura. Kjo ka qenë, nëse s'gabo, përgjigjja e ekspertëve të asaj kompanie. Faleminderit.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Unë jo që kam qenë pjesëmarrës me ju aty, por kam lexuar dhe realisht, edhe unë në fillim kur e kemi bërë projektin, ka qenë që të mos kalohet fare me makina, vetëm emergjenca: policia, zjarrfikësit. Për kamionë edhe sot është e ndaluar. Unë po flas për vetura, sepse më është thënë me dokument nga operatori se e keni ndryshuar me kuvend, që të hyhet me vendim të kuvendit. Dihet që një projekt që punohet nuk duhet të ndërhyhet, pastaj kur ndërhyhet në të, dihen pasojat.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. Unë mendoj që, përveç asaj që zyrtarisht kanë qenë në ato kohë dhe janë aprovuar, pjesa praktike është pak tjetër, sepse ti nuk mundesh me ndalu kamionin e zjarrfikësve të mos hyjë në qytet, nuk mundesh me ndalu kamionin e mbeturinave të mos hyjë në qytet. Pra, janë realisht peshat më të rënda që nuk mund t'i identifikosh jashtë zonës së qytetit. Kështu që kot mund të themi aty që lejohen apo s'lejohen, sepse ato nuk mund t'i ndalësh; ato s'kanë ndryshe si të veprojnë. Por sido që të jetë, nënkryetari do të marrë fjalën. Unë mendoj që kjo që thatë ju, se është mirë të thirret dikush prej ekspertëve në seancë, nuk ka asgjë të keqe. Por tash dihet që i kemi rekomandimet vetëm për seancë këtu. Besoj që keni kohë edhe si grupe parlamentare, edhe të tjerët, prapë me bisedu dhe me ardhë në një qëndrim që duhet ta kemi më 27-tin në seancë. Faleminderit.

Fadil Gashi, nënkryetar: Faleminderit, kryesues. E para, ky shesh ka pasur një vendim të kuvendit; është miratuar projekti në kuvend, edhe pse ne kemi qenë në opozitë si LDK, por është miratuar në kuvend dhe i është nënshtruar procedurave të prokurimit dhe tenderimit, dhe është ndërtuar si është ndërtuar, me një pranim teknik pastaj nga një pushtet tjetër. Por kjo nuk do të thotë që s'ka nevojë të ndryshohet. Diçka që ndërtohet me rërë nuk është domosdoshmërisht që duhet të ruhet ashtu. Edhe ne e kemi thënë, kemi pasur një lloj iniciative, ata që kemi qenë në mandat, këta që e latë pas; edhe në kuvend e kemi inicuar edhe njëherë. Edhe kështu kam thënë në kuvend dhe po e përsëris edhe njëherë para jush: ky shesh, as atëherë kush e ka ndërtuar, as atëherë kush e ka bërë pranimin teknik, as sot kush po e bën, nuk duhet të ketë ngjyrë politike të asnjë subjekti, sepse këtë po e urrejnë të gjithë qytetarët. Unë po e shoh se këtu po zbutet pak

gjuha; nuk është që po na dërgojnë vërejtje verbale apo me shkrim, ata edhe po na shajnë, një pjesë e qytetarëve, sepse ata e frekuentojnë më shumë ndonjëherë sesa ne. Edhe këtë projekt, ne kemi qenë dëshmitarë: ka ardhur projektuesi me profesionistët dhe ata e kanë bërë këtë vlerësim. Nuk e kemi marrë ne as ju; ne po marrim informacione zyrtare profesionale. Cila është kostoja më e lirë? Besoj se të gjithë e keni të qartë: ndërhyrja nuk ka dilemë që duhet të bëhet, por tash profesionistët e kanë bërë këtë prezantim që kostoja është më e lirë me këto që u prezantuan prej drejtorit. Me 1 milion e 500 mijë euro, që ka qenë edhe galeria nëntokësore, të rritet një sipërfaqe mbitokësore, siç u prezantua këtu. Unë edhe njëherë po ju lus: tash po kthehemi te ajo pikë – a rekomandim apo vendim. Ky komitet jep rekomandim, ndërsa vendimin final e merr kuvendi. Atje duhet të ketë debat. Prej nesh këtu në Komitetin për Politikë dhe Financa kërkohet një rekomandim për në kuvend; pastaj është kuvendi që nxjerr vendimin final. Unë do të doja të arsyetonte i gjithë kuvendi dhe të ndryshojë sipas kërkesave profesionale, siç i kanë bërë inxhinierët e fushave përkatëse. Prandaj nuk besoj që ka te asnjëri prej nesh arsye për të mos i dhënë kësaj konotacione se kush ka qenë ky subjekt, kush vjen e kush del. Nesër mund të hiqet edhe ky objekt krejt komunave; ka qenë një komunë tjetër, është bërë tjetër, varësisht prej rrethanave. Është bërë ndryshim edhe në hartat zonale, ju e keni parë. Ne kemi filluar procedurën; është një dokument që nuk i përgjigjet më kohës dhe duhet të ndryshohet me pjesë të reja, me realitete të reja. Faleminderit, kryesues.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, nënkryetar. Dikush tjetër? Urdhëro, Mendehie Duraku.

Mendehie Duraku: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket drejtimit të këtij sheshi, desha ta pyes drejtorin se kur ka mundësi të fillojë ndërtimi i këtij sheshi, sepse, siç e dimë, në muajt korrik dhe gusht vijnë edhe gurbetqarët dhe bëhet një kaos. Me thënë të drejtën, nuk kemi nga të lëvizim ne që jetojmë këtu dhe veprojmë. Kështu që, si sugjerim, kisha pasur dëshirë të lihet në disa muaj që nuk na pengon as neve dhe bëhet më lehtë ndërtimi i këtij sheshi. Sa i përket ndërtimit, se si është bërë, si dhe investimeve pas ndërtimit, unë mendoj, me thënë të drejtën, nuk ka pasur profesionalizëm, sepse kalldrëmin, edhe pse jam femër, mendoj që gjithkush nuk mundet me e shtruar. Edhe investimet që i keni bërë më pas, i kemi parë dhe kemi qenë të vetëdijshëm për atë punë që është bërë, që nuk është bërë si duhet dhe nuk është e lehtë që gjithkush ta marrë një punë dhe ta bëjë, dhe po shihet si është bërë. Faleminderit shumë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Mendehie. Po, drejtor.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit e nderuar. Ideja është të përfundojë në korrik, por ju e dini se ka procedura. Na duhet, në radhë të parë, ta marrim grantin, por nuk varet prej neve, varet prej nivelit qendror. Ideja jonë është që të mos hyhet mbi 20 korrik të përfundojë, dhe do të shkojmë me faza. Faza e parë do të përfundojë deri te sheshi, përfundon kjo dhe kthehet mbrapa tjetri, me kusht që të mund të bëhet lëvizje dhe të mos bllokohet kot qarkullimi. Mirëpo plani dhe ideja është që të përfundojë para korrikut, domethënë në gjysmën e korrikut të jetë e përfunduar, por varet edhe prej anëve të tjera.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Por unë po dua t'i bashkohem kërkesës së Mendehies: nëse për shkak të procedurave mund të vonohet, nuk është problem pse marrim vendim që të shtyhet për më vonë, por e rëndësishme është që ne ta dimë ku jemi dhe çka po bëjmë. Urdhëroni, Arben Limani e ka fjalën.

Arben Limani: Përshëndetje për të gjithë. Unë desha ta pyes drejtorin: aty, sa e pashë unë pjesën e sheshit, mu duk se do të vazhdojë, pasi janë në “kocka” prej pamjes vizuale, kështu siç u pa. Nëse ajo do të vazhdojë të mbetet në “kocka”, a do të priset ajo si kjo pjesa tjetër, sepse bie që të investohet prapë? Përndryshe, projekti ka qenë milionësh; ne këtu jemi dakorduar në asamble për atë projekt. Ndoshta për seancën e ardhshme është mirë që jo vetëm trupa profesionale e Drejtorisë së Urbanizimit, por edhe zyra ligjore të na ndihmojë, që mbi një projekt 1.5 milionë sa ka kushtuar, ndoshta edhe më shumë, të mos e hedhim poshtë atë projekt milionësh, që është një investim i domosdoshëm, sepse të gjithë jetojmë dhe na bie të kalojmë nëpër qendër të qytetit, dhe po e dimë që është bërë e pakalueshme si pjesë e rrugës. Pra, të plotësohet edhe ana ligjore e kësaj, nëse mund të investohet, sepse në njëfarë forme po i bie të hidhet ai projekt komplet dhe të investohet në diçka tjetër. Edhe kjo që e thashë për drejtorin: nëse vazhdohet me mbet në “kocka”, do të ndërhyhet prapë, sepse ne s’po kemi kompani që dinë me shtruar kalldrëm, thjesht. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Arben.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Arben, ajo është përafërsisht 900 metra, ai rrethi i ka afërsisht, dhe aty do të ndërhyhet për t’u rregulluar dhe do të bëhet një bazë pak më e qëndrueshme. Mirëpo nuk është njësoj si me kaluar 900 metra dhe si me kaluar 10 metra. Sa i përket kostos që po thua ti, mbi një milion e gjysmë, mos i merrni për bazë se është gjithçka me u ndërru, sepse çmimet janë të asaj kohe, afërsisht 25–30%. Kjo i bie që, kur të llogaritet komplet, del rreth 250 mijë euro. Mos e merrni për bazë se po ndërrohen 1 milion e gjysmë, sepse nuk po ndërrohen aq, por po ndërrohen rreth 250 mijë euro, të cilat i ka 10 vjet që janë ndërtuar. Për 10 vjet harxhohet gjithçka dhe besoj që shumë më lehtë mirëmbahet me 900 mijë sesa më shumë.

Enver Berisha, kryesues: Drejtor, a po pajtoheni që në seancë të vijë dikush prej ekspertëve dhe të bëjë një sqarim shtesë, nëse na duhen? Kush është për rekomandim për kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për rindërtimin e sheshit të qytetit të Klinës, me 6 vota PËR dhe 1 kundër, rekomandoi që në seancë të vijë një ekspert i fushës (Inxhinier) ku do ta paraqes projektin në detaje, po ashtu, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa 2025–2026.

Kërkesa 1.

Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të parcelës Nr. P-126-0 Z.K.Gllarevë, me sipërfaqe prej 2150m² e cila evidentohet në emër të Komunës së Klinës. Parashtruesi i kërkesës, z. Ndriqim Veselaj nga Fshati Gllarevë, Komuna e Klinës, i cili thekson: Unë, Ndriqim Veselaj kam interes

që të marr në shfrytëzim këtë parcelë, për të filluar një biznes, andaj bazuar në Ligjin nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkoj që të më jepet në shfrytëzim, gjithashtu pranoj që të paguaj taksën komunale të cilën do ta caktojë organi juaj komunal në emër të dhënies në shfrytëzim dhe për këtë parcelë.

Enver Berisha, kryesues: Është mirë që këto kërkesa të harmonizohen edhe me listën që e keni bërë për dhënie në shfrytëzim të pronave këtë vit, por kisha rekomanduar që këto të dërgohen në Zyrën e Kryetarit, që ta marrin vlerësimin nëse janë në rregull apo jo. Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e z. Ndriqim Veselaj për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale t'i dërgohet Zyrës së Kryetarit, me qëllim të veprimit në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga z. Mihill Quni nga fshati Budisalc, i cili thekson se ka në shfrytëzim që një kohë parcelën me nr. P-71011011- 00149-1, ZK Budisalc P.sh. Komuna e Klinës, në sipërfaqe prej 22712 m² . Andaj, kërkon nga Komuna e Klinës që t'i jepet në shfrytëzim prona e lartpërmendur.

Enver Berisha, kryesues: Edhe kjo të shkojë në Zyrën e Kryetarit dhe të harmonizohet me listën e pronave dhe me ligjin. Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e z. Mihill Quni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale t'i dërgohet Zyrës së Kryetarit, me qëllim të veprimit në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 3.

Kërkesë e parashtruar nga z. Shaban Gashi, i cili me anë të kësaj kërkesë, kërkon ndërtimin e disa krojeve për ujë të pijes në qytetin e Klinës, nga tre deri në shtatë kroje, sipas mundësisë që ka Komuna e Klinës.

Enver Berisha, kryesues: Kjo kërkesë më shumë duhet t'i adresohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Është kërkesë për të pasur një çezmë me ujë në qytetin e Klinës dhe është plotësisht e

arsyeshme. Duhet të gjendet vendi ku, por sido që të jetë, duhet të trajtohet.

Esat Raci: Nuk e di tash me fol me operatorin i cili është duke ndërtuar te Dushët. Ajo ka qenë funksionale dhe të bëhet ajo çezma e qytetit që ka qenë te familja Dushi. Ata janë të gatshëm prapë; në bisedë me Baki Dushin, thotë që prapë do ta bëjë funksionale. Është bash në qendër, por nëse ka mundësi për vende të tjera në qytet, është edhe më mirë.

Enver Berisha, kryesues: Atëherë ne po e drejtojmë kërkesën në Shërbime Publike dhe ata me siguri kontaktojnë edhe me familjen Dushi, dhe nëse ka edhe ndonjë vend shtesë, në komunë të vendoset ndonjë çezmë e re. Kush është për rekomandim për seancë?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Shaban Gashi, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Kërkesa 4.

Kërkesë e parashtruar nga banorët të cilët banojnë në objektin “Benita Company” në Klinë, me anë të së cilës kërkojnë nga Komuna e Klinës, në bashkëpunim me banorët, të bëhet rregullimi i liftit i cili është në llamellën e 4-të Nr.103, pasi që është jashtë funksionit nga muaji qershor 2025.

Enver Berisha, kryesues: Është lista, e keni parë besoj të gjithë, me nënshkrime. Kjo temë ka qenë edhe vitin e kaluar për disa objekte të tjera, por realisht ende nuk kemi arritur të realizojmë asgjë prej kësaj. Unë jam i sigurt që kërkesa e këtij objekti është e arsyeshme, por duhet ta vendosim këtë çështje edhe për këtë objekt, edhe për objektet e tjera. Është mirë që këto objekte të bëjnë një zgjidhje të përhershme, sepse të gjitha janë marrë me ashensor. A ka dikush diçka për të thënë apo jemi për bartje në asamblenë komunale?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga banorët të cilët banojnë në objektin “Benita Company” në Klinë, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

Pika 8. Të ndryshme.

-Kërkesë e parashtruar nga OVL-UÇK me nr. Prot. 01-221-7475/2026 të datës 13.03.2026, me anë të së cilës kërkojnë që t'i jepet në shfrytëzim një veturë nga Komuna e Klinës, e cila do të shërbente për zyrtarët e OVL-UÇK-së, dega në Klinë. Po ashtu, kërkojnë që vetura të jetë pronë e përhershme e OVL-së.

Enver Berisha, kryesues: Kërkesa e fundit që ka ardhur më vonë dhe nuk ka qenë në material është për kategoritë e dala nga lufta. Këta kanë bërë një kërkesë që, në marrëveshje edhe me ne, t'u dhurohet një veturë zyrtare. Mirëpo për seancë, bashkë me Ahmetin, u kemi kërkuar edhe librezën e veturës, sepse duhet të dimë specifikat: cila veturë do t'u jepet shoqatave të dala nga lufta. Besoj që edhe me këtë pajtoheni. A jeni që kjo të aprovohet?

Pas shqyrtimit të kërkesës së OVL-UÇK-së, dega në Klinë, nga ekzekutivi u theksua se Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, ka propozuar që t'i dhurohet një veturë për nevojat e zyrtarëve të OVL-së, por që detajet e veturës së bashku me propozim do të sjellën për shqyrtim në Kuvend.

-Propozimi për zgjedhjen e delegatëve për AKK (Asociacioni i Komunave të Kosovës).

-Kryesuesi njoftoi se kemi një kërkesë nga ana e Asociacionit të Komunave të Kosovës për zgjedhjen e delegatëve nga Kuvendi i Komunës të cilët duhet të përfaqësojnë Komunën e Klinës si delegat për AKK, andaj vendimi duhet të merret në Kuvend.

Enver Berisha, kryesues: Është në planin e Kuvendit edhe vizita në Gjermani, pra ka vendim në planin e punës dhe nuk kemi nevojë për vendim shtesë, vetëm afatin do ta marrim vesh në seancë për shkak të procedurave.

Fadil Gashi, nënkryetar: Vetëm na duhet, si herëve të tjera, komunikimi për shkak të numrit, sepse kur të fillojmë procedurat e prokurimit duhet ta dimë saktë për akomodimin, sa meshkuj, sa femra. Është procedurë e veçantë dhe merr kohë për shkak të angazhimit të kompanive turistike, sepse planifikimi është në maj dhe procedura merr kohë, prandaj është mirë të definohet numri.

Mendehie Duraku: Për cilën datë të majit, përafërsisht?

Enver Berisha, kryesues: Është pas 15 majit. Kësaj radhe nuk do të rrimë tri netë, por do ta bëjmë një zgjidhje pak më të gjatë, katër netë. Besoj se nga 20- 25 maji do të ishte koha më e mirë, edhe për shkak të kushteve atmosferike. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë, por për afatin mund të diskutojmë edhe në Asamble. Është mirë që ju të bisedoni me grupet tuaja, siç tha nënkryetari, që të deklarohet me kohë kush do të vijë dhe kush jo, për shkak të procedurave. Dikush tjetër? Faleminderit shumë për pjesëmarrje dhe angazhim.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi - Gojani



Kryesuesi,
Enver Berisha

